



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:125589
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05463514

Ac.nr.8908/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar i kolegjit, Faton Ademi, dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore e sipas padisë së paditësit, F. U. nga fshati K., Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson, av. V.. O... nga Prizreni, të paraqitur kundër të paditurës Posta e Kosovës Sh.A. me seli në Prishtinë, e të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i saj R.. H. nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, duke vendosur lidhur me ankesat e paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.492/2017 datë 17.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN të pa themelta ankesat e paditësit F. U. nga fshati K., Komuna e Prizrenit, ashtu që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.492/2017 datë 17.09.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.492/2017 datë 17.09.2021, ka vendosur: I. REFUZOHET tërësisht si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, F. U. nga fshati K., Komuna e Prizrenit, përmes të cilës ka kërkuar që të “OBLIGOHET e paditura, Posta e Kosovës me seli në Prishtinë që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, t’ia paguajë shumën në lartësi prej 38,564.00 €, duke e llogaritur edhe kamatën ligjore prej 8 % prej ditës së marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 2,181.40 €”. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e paditësit dhe ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe ta aprovojë në tërësi kërkesë padinë e paditësit si të bazuar apo të njëjtin ta prishë dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallë së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Përgjigje në ankesën e paditësit ka parashtruar e paditura me propozim që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, në ankesa, si dhe analizimin dhe vlerësimin e shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, ka gjetur se:

-Ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi F. U. nga fshati K., Komuna e Prizrenit, me datë 21.04.2017, në Gjykatën e shkallë së parë, ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit material dhe jo material, kundër të paditurës Posta e Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë, me kërkesë si në parashtrësën mbi precizimin e kërkesë padisë e datës 26.06.2021.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesore, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave, ka marr aktgjykim C.nr.492/2017 datë 17.09.2021, ka vendosur që të refuzoj në tërësi si të pa bazuar kërkesë padinë e paditësit, duke vendosur më konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se: Gjykata nga administrimi i provave të paraqitura më lartë, vlerëson se si çështje jo kontestuese, na paraqitet ekzistimi i aksidentit të komunikacionit të ndodhur më datë 01.10.2015, nga i cili aksident paditësi ka pësuar lëndime trupore. Mirëpo, si çështje kontestuese, na paraqitet përgjegjësia e të paditurës që me mjetin motorik, pronë e të paditurës, paditësi është lënduar në punë me rastin e ngasjes së të njëjtit dhe që si pasojë e defektit apo gjendjes jo të mirë teknike të mjetit në fjalë, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit më datë 01.10.2015. Në të vërtetë, fakti i ndodhjes së aksidentit dhe shkaktimi i lëndimeve trupore ndaj paditësit F. U., është provuar nga raporti i aksidentit nr. 2015-GR-0334 të datës 01.10.2015, përmes së cilës provë përshkruhet rrethanat dhe mënyra e ndodhjes së aksidentit të datës 01.10.2015. Po ashtu, lëndimet trupore të shkaktuara nga aksidenti në fjalë, provohen nga dokumentacioni mjekësor, por edhe nga ekspertiza mjekësore, ortopedike-traumatologjike të datës 26.05.2021 të Dr. V.. B. nga Prishtina dhe ekspertizës mjekoligjore psikiatrike të datës 31.05.2021, të hartuar nga Dr.sci. N.. F. nga Prizreni.

Më tej ka shtuar se: lidhur me përgjegjësinë e të paditurës që paditësi me mjetin motorik, pronë e të paditurës, është shkaktuar aksidenti si pasojë e defekteve teknike, gjykata duke vepruar sipas dispozitës ligjore, respektivisht nenit 136 par. 1 të LMD-së, ku shprehimisht përcaktohet që në qoftë se dëmtuesi i shkakton dëm tjetrit, ka për detyrim që t'ia kompensojë atij, përveç nëse vërtetohet se

dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Rrjedhimisht, nga vet deklarimi i paditësit, F. U. në cilësi të palës në shqyrtim kryesor, rrjedh se mjeti motorik, përkatësisht motoçikleta me të cilën është shkaktuar aksidenti dhe si pasojë e këtij aksidenti i njëjti ka pësuar lëndime trupore, atë ditë kur ka ndodhur aksidenti, deri sa ka lëvizur me motoçikletë, motoçikleta ka qenë në gjendje të rregullt. Gjithashtu, në ndërlidhje me dispozitën ligjore të lartcekur, mbi të gjitha lidhur me bazën juridike në të cilën paditësi pretendon se padia e tij është e bazuar, konkretisht nga neni 154 dhe 155 të LMD-së, sipas të cilave dispozita ligjore theksohet se dëmi që shkaktohet lidhur me sendin e rrezikshëm, konsiderohet se rrjedh nga ky send dhe për këtë dëm përgjigjet zotëruesi i saj, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit. Pra, nga provat e administruara, më konkretisht nga vet deklarata e paditësit në cilësi të palës dhe nga raporti i aksidentit numër 2015-GR-0334, në mënyrë të qartë provohet fakti se mjeti motorik, gjegjësisht motoçikleta me të cilin ka ndodhur aksidenti i komunikacionit më datë 01.10.2015, në momentin kur ka ndodhur aksidenti në fjalë, ka qenë në gjendje të rregullt dhe nuk ka pasur ndonjë defekt teknik, dhe se shkaktar i këtij aksidenti, ka qenë paditësi me pakujdesinë e tij gjatë ngasjes së motoçikletës.

Më tej ka shtuar se: Kësisoj, nga raporti i aksidentit 2015-GR-0334 të datës 01.10.2015, prezantohet qartë se aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve subjektive të paditësit, pasi që i njëjti gjatë ngasjes së motoçikletës, nuk ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe nga kjo ka ndodhur aksidenti në fjalë ndërsa, pretendimi i palës paditëse se mjeti motorik konkret nuk ka qenë në gjendje të rregullt dhe ka pasur defekte teknike, nuk qëndron e kjo për faktin se nga vet deklarata e palës paditëse, rezulton se në momentin e ngasjes së motoçikletës, ky mjet ka qenë duke punuar dhe në gjendje të rregullt e një fakt i tillë rezulton edhe nga vet komunikimet përmes postës elektronike dhe kontratës publike kornizë, nr. 01-2979/13 të datës 28.10.2013 përmes të cilave shihet se Operatori Ekonomik i autorizuar, ka pasur për detyrë ta bëjë rregullimin dhe servisimin e motoçikletave të Postës së Kosovës, me këtë rast edhe të Zyrës Postare në të cilën ka punuar paditësi. Së këndejmi, nga këto prova dhe fakte rrjedh se e paditura, PK sh.a me seli në Prishtinë, nuk ka asnjë obligim për kompensimin e dëmit ndaj paditësit, sepse e paditura nuk është shkaktare që me mjetin motorik të dëmtuar, ka ardhur deri te shkaktimi i aksidentit të komunikacionit, në të cilin, ka pësuar lëndime të rënda trupore paditësi.

Më tej ka shtuar se: Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, nuk është provuar se e paditura, Posta e Kosovës Sh.A me seli në Prishtinë, ka detyrim për kompensimin e dëmit ndaj paditësit, F. U. nga fshati K., Komuna e Prizrenit, pasi që paditësi në rastin konkret, nuk i ka ofruar gjykatës asnjë provë bindëse në lidhje me përgjegjësinë e të paditurës lidhur me dëmin e pësuar nga paditësi, sa i përket kësaj çështje juridike-kontestimore. Andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi mbi bazën e të lartcekurave dhe duke qenë se paditësi nuk i ka ofruar gjykatës prova të mjaftueshme dhe bindëse, përmes të cilave do të argumentohet drejta e tij në kompensimin e dëmit të pretenduar, edhe pse për këtë në seancën e shqyrtimit kryesor është ftuar nga ana e gjykatës që të propozojë prova të reja, pasi që barra e të të provuarit (*onus probandi*) lidhur me pretendimet e tij, i ka takuar atij, si paditës e për më tepër i njëjti në seancën kryesore, ka deklaruar se motori si mjet motorik, ditën kritike ka qenë në gjendje të rregullt kur ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, kjo gjykatë nuk mund ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit, respektivisht të njëjtën është dashur që ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Më tej ka arsyetuar se: Po ashtu, gjykata vlerësoi edhe vërejtjen e të autorizuarit të paditësit, lidhur me kontratën publike kornizë, nr.01-2979/13 të datës 28.10.2013, me arsyetimin se gjatë komunikimeve me e-mail, njëra nga arsyet e zvarritjes së riparimit të motoçikletave ka qenë mos pagesa e shërbimeve ndaj operatorit që ka ofruar këto servise, ndërsa në komunikim me paditësin na njofton se asnjëherë operatorët e kontraktuar nuk kanë bërë servisimin e tyre që nga nënshkrimi i kësaj kontrate, mirëpo vlerësoi se një vërejtje apo pretendim i tillë është tërësisht i pabazuar dhe nuk ka arsyetim të qëndrueshëm juridik. Në të vërtetë, kontrata e lartcekur është lidhur në përputhje me të gjitha dispozitat e nevojshme ligjore, e nënshkruar nga përfaqësuesit e të paditurës dhe Operatorit Ekonomik në fjalë dhe si e tillë është dokument krejtësisht legjitim e në anën tjetër, pretendimi se motoçikletat asnjëherë nuk janë riparuar nga ana e kontraktuesit, nuk qëndron dhe nuk ka mbështetje të qartë juridike. Kjo për faktin se nga komunikimi përmes postës elektronike të datës 21.04.2015 ndërmjet Sh. Q. dhe S. H., është njoftuar se motoçikleta është prishur dhe nuk punon që nga data 20.04.2015, ndërsa paditësi, F. U. nga fshati K., Komuna e Prizrenit, ditën kur ka ndodhur aksidenti më dt.01.10.2015, ka qenë duke drejtuar motoçikletën në fjalë, me çka rezulton se motoçikleta e njoftuar si e prishur, është servisuar dhe riparuar për shfrytëzim.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 449, 450 dhe nenin 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar palët ankuese me ankesa.

Pretendimet e paditësit se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së me arsyetimin se dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me vetveten dhe arsyetimin si dhe i njëjti nuk mund të ekzaminohet. Një pretendim i tillë nuk qëndron pasi që sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plot me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, nga provat e administruara ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike e cila gjendje faktike i rezulton edhe kësaj gjykate pasi që gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar faktin se më datë 01.10.2015, rreth orës 11:20, kishte ndodhur një aksident i komunikacionit, kur vozitësi- paditësi ishte duke drejtuar motoçikletën e markës Z., të tipit ZN 5012, me targa të regjistrimit 01-...-RA, në qarkullim në rrugën e fshatit C.. dhe me të ardhur përball marketit "B.", paditësi nuk kishte përshtatur shpejtësinë e komunikacionit, sipas kushteve të

rrugës dhe rrethanave në komunikacion dhe me të arritur tek udhëkryqi në formën "...", nga ana e tij e djathtë ndalet një automjet në mënyrë të rregullt në udhëkryq dhe me këtë rast vozitësi i motoçikletës- paditësi frenon vullshëm dhe rrëzohet me motoçikletë mbi sipërfaqen e rrugës, duke rrëshqitur për disa metra e si pasojë e këtij aksidenti, paditësi kishte pësuar lëndime trupore dhe në motoçikletë janë shkaktuar dëme materiale, i cili aksidente ka ndodhur me fajin dhe përgjegjësinë e paditësit dhe jo si pasojë e gjendjes jo të mirë të motoçikletës sepse një fakt të tillë paditësi ka deklaruar në shqyrtim kryesorë se motoçikleta atë ditë ka qenë në rregull.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit në lidhje me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallë së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, kur ka vendosur që ta refuzon kërkesë-padinë e paditësit si të pa bazuar pasi që me provat e administruara, nuk është vërtetuar që e paditura të ketë përgjegjësi për shkaktimin e aksidentit kjo për faktin se aksidenti ka ndodhur me përgjegjësinë e paditësit dhe jo si pasojë e dështimit të të paditurës në ofrimin dhe plotësimin e kushteve të punës dhe si rrjedhojë nuk i ka shkaktuar as dëm paditësit, pasi që me po të njëjtat prova është vërtetuar me pa mëdyshje se shkaktar i këtij aksidenti është vet paditësi, fakt i cili është konstatuar nga raporti i aksidentit 2015-GR-0334 të datës 01.10.2015, por që nuk ka qenë kontestues në mes palëve as mënyra e shkaktimit të aksidentit. Sipas nenit 136 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se *“Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji. Për dëmin, pavarësisht nga faji mbahet përgjegjësia edhe në rastet tjera të parashikuara me ligj”* derisa në nenin 154 të LMD-së, i cili parasheh që: *“Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit”*. Po ashtu në nenin 155 të LMD-së që ka të bëjnë me atë se kush përgjigjet për dëmin, thuhet se: *“Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të”*. Po ashtu me nenin 7.1 të LPK-së është paraparë se: *“Palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Andaj, në rastin konkret është vetëtuar se paditësi me veprimet e tija ka shkaktuar aksidentin dhe si rrjedhojë nuk ka të drejtë të kërkoj nga e paditura kompensimin e një dëmi që është shkaktuar me fajin e tij.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me vetë aksident në komunikacion dhe assesi nuk mund të flitet për lëndime në punë që të burojnë kompensimi i dëmit me përgjegjësi objektive, edhe pse paditësi në kohën e shkaktimit të aksidentit kishte qenë në orar të punës duke kryer detyrat e punës, por kjo nuk nënkupton se çdo lëndim i pësuar në orar të punës duhet të përgjigjet punëdhënësi, kjo për faktin se paditësi me veprimet e tije ka ardhë deri të mos respektimi i rregullave të komunikacionit dhe si pasojë ka ardhë deri te vet aksidenti dhe i njëjti mbanë përgjegjësi për veprimet e tije e gjithashtu edhe për lëndimin e pësuar në këtë aksident sepse e paditura nuk ka ndikim fare në ndodhjen e aksidentit. Fakti që e paditura është pronare e motoçikletës e cila mund të konsiderohet send i rrezikshëm nuk e bën përgjegjëse të paditurën për kompensimin e dëmit, pasi që në kohën e aksidentit paditësi ka qenë duke e drejtuar motoçikletën e që në atë moment ai ka qen zotëruesi i mjetit të rrezikshëm dhe me veprimet e tije është shkaktuar aksidenti dhe jo nga defekti i motoçikletës.

Gjykata e Apelit nuk i morri për bazë pretendimet ankimore të paditësit në lidhje me shkelje të dispozitave të procedurë kontestimore nga neni 182 par. 2 pika i) e LKP-së, pasi që gjykata e shkallës së parë gjatë zhvillimit të procedurës në mënyrë të plotë ka respektuar të drejtat e palëve në procedurë duke i dhënë mundësin secilës palë në paraqitjen e çështjes së tinë në mënyrën e tij si dhe duke i dhënë mundësin e paraqitjes së provave në çdo fazë të procedurës me qëllim të vërtetimit të pretendimeve, por i autorizuar i paditësit në shqyrtim kryesorë pas administrimit të provave, në pyetjen e gjykatës se a kanë propozime tjera për nxjerrjen e ndonjë prove, i njëjti ka deklaruar se nuk kemi ndonjë propozim për nxjerrjen e ndonjë prove të re.

Gjykata e Apelit nuk i mori për bazë pretendimet ankimore të paditësit në lidhje me atë se motoçikleta ka qenë në gjendje jo të mirë pasi që një gjë të tillë paditësi në shqyrtim gjyqësorë kur është dëgjuar në cilësi të palës ka deklaruar se në ditën e aksidentit motoçikleta ka qenë në gjendje të rregullt. Dhe nuk mund të aludohet në me e-mail i datës 21.04.2015, pasi që me këtë email është njoftuar që motoçikleta është e prishur që nga data 20.04.2015 dhe nuk vërteton faktin se e njëjta motoçikletë ka qenë e prishur edhe në ditën e aksidentit, pasi që, që nga koha e email-it kanë kaluar më tepër se 6 (gjashtë) muaj deri në shkaktimin e aksidentit. Fakti se kjo motoçiklete ka qenë e prishur një herë nuk nënkupton se e njëjta nuk mund të kthehet në gjendje të rregullt pasi që e paditura për mirëmbajtjen e motoçikletave por edhe mjeteve tjera motorike kishte kontratë me një operatorë ekonomik dhe një pretendim të tillë sikur ky operatorë nuk i ka rregulluar motoçikletat me kohë nuk mund të argumentohet pasi që paditësi nuk ka ofruar asnjë provë për të vërtetuar një fakt të tillë.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 450 lidhur të LPK-së.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8908/2021 datë 12.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj